

VENDIM
Nr. 12, datë 22.8.2023

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar; në kreun I, neni 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, të ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, të ndryshuar; me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, ‘Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 12, datë 22.8.2023, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Fondi të Arratisur, fashikull nr. 2272, me 51 (pesëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1953–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

2. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje objekti nr. 137, muzeu “Enver Hoxha”, me 2 volume, në total me 43 (dyzet e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

3. Fondi i Veçantë, dosje pa nr., “Valbona”, me 3 volume në total me 503 (pesëqind e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1969–1975. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuara në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KDZH-së
Gentiana Sula